



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 377 / Prot.  
5

Tiranë, më 09 /06/2015

VENDIM

Nr. 36 ,datë 09/6 /2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica" ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 377/4 Prot., datë 27.05.2015, në vijim të ankesës nr. 377 Prot, datë 04.05.2015, ndaj autoritetit publik/ Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare*". Qendra "Res Publica" në cilësinë e kërkuesit, me shkresën nr.047/15 prot., datë 02.04.2015 drejtuar autoritetit publik/ Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion kopje e dokumenteve, konkretisht:

1. Kopje e librit të protokollit të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike (të njësuar me vulën e arkivës).
2. Kopje e procesverbaleve të tre mbledhjeve të fundit të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike (të njësuar me vulën e arkivës).
3. Numrin e aplikimeve për ndihmë juridike falas të ardhura për shqyrtim pranë Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, të ndarë sipas rretheve dhe sipas viteve 2012, 2013, 2014, 2015.
4. Numrin e kërkesave të pranuar për ofrimin e ndihmës juridike falas nga ana e Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, të ndarë sipas rretheve dhe sipas viteve 2012, 2013, 2014, 2015.
5. Numrin e aplikimeve për përjashtim nga taksat gjyqësore gjatë gjithë kohës së funksionimit të Komisionit.
6. Numrin e aplikimeve të pranuar nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike lidhur me përjashtimin nga taksat gjyqësore gjatë gjithë kohës.
7. Numrin e mbledhjeve të bëra nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike të ndara sipas viteve 2012,2013,2014,2015.

Komisioneri pas vlerësimit të ankesës së Qendrës "Res Publica", me Urdhrin nr.93 datë 06.05.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, me qëllim verifikimin e këtyre fakteve. Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Qendrës "Res Publica" është administruar dhe protokolluar nga ana e autoritetit publik me nr.109 prot., datë 10.04.2015.

Pas kryerjes së inspektimit, Autoriteti publik, me shkresën nr.109/1Prot., datë 12.05.2015, i ka kthyer përgjigje Qendrës "Res Publica" duke vënë në dijeni edhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në përgjigjen e dhënë Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike shpjegon se:

1. Për vënien në dispozicion të kopjes së librit të protokollit, kërkuesi duhet të paguajë një tarifë pranë Autoritetit publik.
2. Lidhur me kopjet e procesverbaleve të tre mbledhjeve të fundit të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, Autoriteti publik shpjegon se dokumentacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion sepse në përmbajtje të tij evidentohen të dhëna personale të individëve të cilët kanë aplikuar për ndihmë juridike dhe se këto të dhëna mund të përpunohen nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin.
3. Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike ka vënë në dispozicion të kërkuesit pjesën tjetër të informacionit të kërkuar sipas pikave të sipër cituara nr.3,4,5,6, dhe 7.

Qendra "Res Publica" është shprehur se Autoriteti Publik i ka vënë në dispozicion vetëm një pjesë të informacionit.

Zyra e Komisionerit pas vlerësimit të ankesës së Qendrës "Res Publica" dhe përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik vlerëson se, Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike pasi të ketë përcaktuar tarifën në përputhje me nenin 13 të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", duhet të vërë në dispozicion të kërkuesit kopje të librit të protokollit. Lidhur me procesverbalet e tre mbledhjeve të fundit të Komisionit vlerësohet se ato duhen dhënë në përputhje me parashikimet ligjore të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Lidhur me kërkesën e Qendrës "Res Publica" për numrin e mbledhjeve të bëra nga autoriteti publik sipas viteve rezulton se ky informacion është vënë në dispozicion të kërkuesit me anë të shkresës nr.109/1 Prot., datë 12.05.2015.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", nr.377/4 Prot., datë 27.05.2015, kundër Autoriteti Publik/ Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoriteti Publik/ Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar, konkretisht kopje të librit të protokollit dhe kopje të procesverbalëve të tre mbledhjeve të fundit në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, brenda datës 16.06.2015.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 09.06.2015.

